



Instituti për Tolerancë dhe Mendim Kritik  
**KRITIKOS**

## **Hulumtim i Opinionit publik**

# **Tema: Fragmentarizimi i Shoqërisë në Kosovë**

Nëntor, 2024

## Hyrje

Kosova, si një shtet i ri që shpalli pavarësinë në vitin 2008, vazhdon të përballet me sfida të shumta që kanë evoluar në mënyrë komplekse gjatë viteve të fundit. Këto sfida vijnë jo vetëm nga faktori i jashtëm, por gjithnjë e më tepër edhe nga faktori i brendshëm, duke përfshirë sulme hibride dhe fragmentarizim social, të nxitura nga aktorë të ndryshëm dhe për interesa të ndryshme. Lufta hibride, një lloj konflikti që përfshin mjete të teknologjisë moderne, përfshin tashmë jo vetëm Kosovën por dhe të gjithë botën, duke rezultuar në destabilizim të brendshëm, konfuzion social dhe të ndarë politike.

Zhvillimet teknologjike, përfshirë përhapjen e lajmeve të rreme dhe ndikimin e rrjeteve sociale, kanë rritur ndjeshëm efektin e kësaj lufte hibride, duke e bërë atë një instrument efektiv për arritjen e qëllimeve politike dhe ideologjike. Platforma të ndryshme në internet, të cilat shpesh publikojnë lajme të pavërteta ("fake news") dhe informacione që synojnë të nxisin klikime të shumta ("click bait"), po depërtojnë me lehtësi tek popullata kosovare, duke ndikuar veçanërisht tek rinia. Kjo pjesë vitale e shoqërisë po bombardohet me mesazhe të pavërteta dhe propagandë që shpesh janë në kundërshtim me vlerat e shëndosha sociale e kombëtare.

Strategjia makiaveliste "përçaj dhe sundo" po zbatohet duke shfrytëzuar ndjeshmëritë shoqërore dhe duke përdorur teknologjinë për të përhapur frikë dhe dyshime. Ky tension i krijuar po e vendos Kosovën përballë sfidave që rrezikojnë kohezionin social dhe stabilitetin afatgjatë të vendit.

Ekstremet, qoftë nga aspekti religjioz, politik apo nga ndonjë sferë tjetër, janë bërë më të dukshme dhe më të rrezikshme për shoqërinë tonë. Përhapja e ideologjive të ndryshme ekstreme, sidomos përmes rrjeteve sociale dhe platformave të tjera të komunikimit, ka krijuar mundësinë për ndërhyrje të thellë në strukturat e besimit, identitetit dhe vlerave shoqërore. Kjo fragmentarizim e filluar në fusha të ndryshme rrezikon ta shkatërrojë unitetin e brendshëm dhe t'i japë mundësi aktorëve të huaj të ndikojnë në çështjet e brendshme të Kosovës. Pasojat e një thyerjeje të tillë të brendshme mund të jenë të pariparueshme për dekada të tëra, duke penguar përpjekjet për zhvillim të qëndrueshëm dhe integrim.

Në këtë kontekst, është thelbësore që çdo qytetar i Kosovës të jetë vigjilent dhe të kontribuojë në mbrojtjen e unitetit kombëtar. Kjo është një betejë që kërkon ndërgjegjësim të lartë dhe përgjegjësi të përbashkët për të mbrojtur integritetin e shoqërisë sonë. Ndërhyrjet dhe përgjigjet ndaj këtyre sfidave duhet të jenë të shpejta dhe efektive, duke u bazuar në hulumtime të cilat ofrojnë një pasqyrë të qartë të situatës dhe masave të nevojshme për mbrojtjen e komunitetit.

Instituti Kritikos ka identifikuar disa pika të dobësisë, ku sulmet e jashtme dhe të brendshme po tentojnë të përçajnë dhe destabilizojnë shoqërinë kosovare. Këto pika përfshijnë:

1. **Përçarjen e brendshme mes popullatës që jeton në Kosovë dhe pjesës tjetër në diasporë**, duke përdorur mesazhe që nxjerrin në pah dallime të ndjeshme përmes rrjeteve sociale, ku ironia apo shakatë shpesh përdoren për të ndezur inate dhe përçarje.
2. **Përçarjen mes Kosovës dhe Shqipërisë**, që po manifestohet përmes narrativeve të ndryshme që nxisin rivalitet dhe mosbesim, duke u mbështetur në stereotipe historike dhe ngjarje aktuale.
3. **Përçarjen mes muslimanëve dhe katolikëve**, ku grupacione ekstreme, si të vjetra ashtu edhe të reja, po tentojnë të krijojnë përçarjen më të madhe në historinë shqiptare, duke manipuluar besimet dhe ndarjet kulturore për qëllime politike apo ideologjike.
4. **Feminizmi ekstrem**, një lëvizje që ka nxitur një ndarje të paprecedentë gjinore, duke ndikuar në një polarizim të skajshëm rreth çështjeve gjinore në vend dhe duke lënë ndikim në unitetin e përgjithshëm shoqëror.
5. **Lojrat e rrezikshme dhe ndikimi i platformave sociale si TikTok dhe Roblox**, të cilat promovojnë dhunën dhe që për të rinjtë po e kthejnë atë në një normë të pranueshme, duke prekur kështu moshën shumë të reja që nga shkolla fillore e deri tek të rinjtë në shkollën e mesme.

Këto rreziqe, të përkeqësuar nga ndikimi i informacionit të shtrembëruar dhe fuqizimi i ndasive, kërkojnë qasje të reja dhe masa të efektshme për të parandaluar një fragmentarizim të thellë të shoqërisë kosovare.

## **Qëllimi dhe Objektivat e Hulumtimit**

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizohet fragmentarizimi i shoqërisë në Kosovë, duke identifikuar dhe vlerësuar faktorët kryesorë që kontribuojnë në ndarjen e shoqërisë në Kosovë. Hulumtimi do të përqendrohet në metodën kuantitative përmes një pyetësi të strukturuar nga lartë-poshtë. Në këtë kontekst, "nga lart-poshtë" do të thotë se pyetësi është i strukturuar nga pika fillestare e asaj që synohet të kuptohet, duke zbërthyer temën nga perspektiva më e gjerë në pyetje specifike dhe opsione përgjigjesh. Kjo do të thotë që hulumtimi fillon nga një kuadër teorik dhe objektiva kryesore, duke i zbërthyer ato në pyetje specifike dhe opsione të përgjigjeve të cilat drejtohen në çështjet që kërkojnë të kuptojmë. Fillimisht, pyetësi fokusohet në aspektet më të përgjithshme të fragmentarizimit social, për të kaluar më pas tek pyetjet më specifike që shqyrtojnë faktorë individualë, si ndasitë fetare, ndarjet etnike, ndikimin e mediave dhe ekstremizmin.

Kjo qasje nga lart-poshtë mundëson një analizë të plotë dhe të strukturuar të fenomeneve të ndryshme që kontribuojnë në përçarjet sociale, duke na dhënë një pasqyrë të qartë dhe të detajuar mbi perceptimet dhe qëndrimet e popullsisë ndaj këtyre faktorëve. Përgjigjet e mbledhura do të ndihmojnë në vlerësimin e peshës së secilit faktor në ndarjen sociale, duke e orientuar hulumtimin drejt identifikimit të zgjidhjeve të mundshme dhe ndërhyrjeve që synojnë të forcojnë kohezionin shoqëror në Kosovë.

## Metodologjia

Ky hulumtim do të përdorë metoda kuantitative përmes pyetësorëve të strukturuar, dhe rezultatet do të analizohen duke përdorur programin **SPSS (Paketa e Statistikave për Shkenca Sociale)** për përpunim të të dhënave dhe **PowerBI** për vizualizimin e analizave.

## Mostra e Hulumtimit

Mostra do të përbëhet nga një grup përfaqësues prej mbi **300 respondentësh**, e përlogaritur duke përdorur **Formulën e Slovin-it**, dhe do të merret në nivel familjar (Household level), për të siguruar që rezultatet përfaqësojnë të gjithë popullsinë e Kosovës.

## Detaje mbi Mostrën

- **Target Grupi:** Popullata e Kosovës, në të gjithë vendin
- **Mostra:** E zgjedhur në mënyrë rastësore, duke përfshirë zona urbane dhe rurale
- **Numri i Respondentëve:** Mbi 300
- **Mosha e Përfshirë:** 16-65 vjeç
- **Niveli i Edukimit:** Të gjitha nivelet
- **Etnia:** Diversiteti etnik i popullsisë së Kosovës
- **Përkatësia Fetare:** Të gjitha grupet fetare të përfaqësuara

## Pyetjet

### 1. Cila është mosha juaj?

- 16-25 vjeç
- 26-35 vjeç
- 36-45 vjeç
- 46-55 vjeç
- 56-65 vjeç
- Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem

2. **Ju lutem, a mund të na thoni vendbanimin tuaj?**

- Prishtinë
- Mitrovicë
- Pejë
- Prizren
- Ferizaj
- Gjilan
- Gjakovë

3. **Ju lutem na thoni nese vendbanimi juaj është...**

- Rural
- Urban

4. **Cili është niveli juaj i arsimimit?**

- Pa arsimim
- Arsimi fillor
- Arsimi i mesëm
- Arsimi i lartë (universitar)
- Master/PhD
- Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem

5. **Cila është përkatësia juaj fetare?**

- Musliman
- Katolik
- Ortodoks
- Ateist
- Tjetër
- Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem

6. **Sa mendoni se është i pranishëm fragmentarizimi i shoqërisë në Kosovë?**

- Shumë i pranishëm
- Mjaft i pranishëm
- Mesatarisht i pranishëm
- Pak i pranishëm
- Nuk është fare i pranishëm
- Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem

7. **Si vlerësoni ndikimin e mediave sociale në përçarjen sociale në Kosovë?**
- Shumë të lartë
  - Të lartë
  - Mesatar
  - Të ulët
  - Shumë të ulët
  - Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem
8. **Cili është ndikimi i përçarjes mes grupeve fetare në shoqërinë kosovare?**
- Ndikim shumë i madh
  - Ndikim i madh
  - Ndikim mesatar
  - Ndikim i ulët
  - Nuk ka ndikim fare
  - Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem
9. **A mendoni se përhapja e lajmeve të rreme dhe “fake news” ka ndikuar në ndarjet sociale në Kosovë?**
- Po, ka ndikuar shumë
  - Po, ka ndikuar disi
  - Ka ndikuar pak
  - Ka ndikuar shumë pak
  - Nuk ka ndikuar fare
  - Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem
10. **Sa i madh mendoni se është ndikimi i përçarjes mes shqiptarëve të Kosovës dhe atyre në diasporë?**
- Shumë i madh
  - I madh
  - Mesatar
  - I ulët
  - Nuk ka ndikim fare
  - Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem
11. **Sa rëndësi ka, sipas jush, ekstremizmi fetar në fragmentarizimin e shoqërisë në Kosovë?**

- Shumë i rëndësishëm
- I rëndësishëm
- Mesatarisht i rëndësishëm
- Pak i rëndësishëm
- Nuk është aspak i rëndësishëm
- Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem

12. **Në çfarë mase mendoni se lëvizjet e ekstremizmit gjinor po ndikojnë në përçarjen e shoqërisë kosovare?**

- Ndikojnë shumë
- Ndikojnë disi
- Ndikojnë mesatarisht
- Ndikojnë pak
- Nuk ndikojnë fare
- Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem

13. **A mendoni se lojërat online dhe rrjetet sociale ndikojnë në normalizimin e dhunës tek të rinjtë?**

- Po, shumë
- Po, disi
- Mesatarisht
- Pak
- Nuk ndikojnë fare
- Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem

14. **A mendoni se përçarja e shoqërisë financohet nga agjenda të huaja?**

- Po
- Jo
- Ndoshta
- Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem

15. **Cilat janë platformat e juaja të preferuar që i përdorni për informim?**

- Televizionet
- Rrjetet Sociale
- Portale
- Të tjera
- Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem

16. **Si e vlerëson rolin e mediave/portaleve dhe efekti i tyre në**

## shoqëri?

- Shumë i madhë
- I madhë
- Mesatar
- I vogël
- Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem

17. **17. Si e vlerëson rolin e mediave/portaleve në sigurinë kombëtare?**

- Shumë i madhë
- I madhë
- Mesatar
- I vogël
- Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem

18. **A mendoni se mediat dhe portalet janë duke ndihmuar apo dëmtuar sigurinë kombëtare?**

- Po e dëmtojnë
- E ndihmojnë
- Nuk kanë efekt në sigurinë kombëtare
- Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem

19. **A keni vërejtur raste kur mediat ose portalet kane ndikuar negativisht po kane dëmtuar sigurinë kombëtare?**

- Po, kam parë raste të shumta
- Jo, nuk kam vërejtur ndonjë ndikim negativ
- Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem

20. **Cilat nga këto shtetë mendoni se financojn agjenda për përçarjen e shoqërisë në Kosovë?**

- Rusia
- Kina
- Serbia
- SH.B.A.
- Shtete të bashkimit European

- Shtetet Arabe
- Tjetër
- Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem

21. **Cilat masa mendoni se do të ndihmonin më shumë për të reduktuar fragmentarizimin në Kosovë?**

- Forcimi i edukimit dhe ndërgjegjësimit social
- Kontroll më i rreptë mbi përmbajtjen e rrjeteve sociale
- Mbështetje për integrimin e komuniteteve të ndryshme
- Bashkëpunim më i madh ndërmjet institucioneve dhe shoqërisë civile
- Përfshirja aktive e liderëve fetarë dhe komunitarë
- Nuk e di / Refuzoj të përgjigjem

Ky hulumtim është konceptuar si një studim afatgjatë, me një periudhë prej 3 deri në 5 vjet, dhe përfshin cikle të përsëritura të mbledhjes së të dhënave çdo katër-gjashtë muaj. Synimi i kësaj qasjeje afatgjatë dhe sistematike është të krijohet një monitorim i vazhdueshëm i fragmentarizimit social në Kosovë dhe të dokumentohet progresi ose regresi i fenomenit në bazë të faktorëve kyç që ndikojnë në përçarjen shoqërore.

Kjo përsëritje e pyetësorit çdo katër-gjashtë muaj ka disa avantazhe kryesore:

1. **Monitorimi i Ndryshimeve Sociale në Kohë Reale**

Duke u bazuar në cikle të shkurtra kohore, hulumtimi mundëson identifikimin e ndryshimeve të menjëhershme në perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve ndaj faktorëve që kontribuojnë në fragmentarizimin e shoqërisë. Kjo ofron një mundësi për të dokumentuar me saktësi trendet dhe për të parë nëse masat e ndërmarra kanë një ndikim pozitiv apo negativ në përçarjet shoqërore.

2. **Analiza e Progresit dhe Regresit**

Të dhënat e mbledhura në intervale të rregullta lejojnë krahasimin e rezultateve nga cikli në cikël, duke mundësuar matjen e progresit apo

regresit në lidhje me faktorin e fragmentarizimit. Në këtë mënyrë, institucionet dhe palët e interesuara mund të kuptojnë më qartë nëse masat e marra kanë ndikuar në përmirësimin e kohezionit social apo nëse janë të nevojshme ndërhyrje të tjera.

3. **Sigurimi i Kohës për Ndërhyrje**

Duke e kryer hulumtimin çdo katër muaj, krijohet mundësia për të ndërhyrë në kohë sa herë që trendet tregojnë përkeqësim. Ky qasje proaktive ofron institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile një mundësi për të reaguar shpejt ndaj sfidave, duke aplikuar masa që synojnë uljen e tensioneve dhe rritjen e solidaritetit social.

4. **Përgatitja për Rekomandime të Bazuar në Të Dhëna**

Të dhënat e grumbulluara në një periudhë të gjatë kohore dhe analizat e vazhdueshme sigurojnë një bazë të qëndrueshme për nxjerrjen e rekomandimeve afatgjata dhe strategjive të politikave publike. Këto rekomandime do të jenë më të sakta dhe të qëndrueshme, pasi do të bazohen në të dhëna të përsëritura që reflektojnë realitetin e ndryshueshëm social në Kosovë.

5. **Krijimi i një Platforme për Edukimin Publik dhe Ndërgjegjësimin**

Duke ndarë me publikun dhe institucionet rezultatet e hulumtimit pas çdo cikli, krijohet një mundësi për ndërgjegjësimin e popullatës lidhur me çështjet që përbëjnë rrezik për kohezionin shoqëror. Kjo qasje kontribuon në ndërtimin e një mjedisi më të qëndrueshëm dhe të vetëdijshëm, ku qytetarët dhe komunitetet janë të informuar dhe të përfshirë në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme.

Me këtë strategji afatgjatë dhe të përsëritur, hulumtimi synon jo vetëm të analizojë, por edhe të kontribuojë në ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe të bashkuar në Kosovë, e cila është e aftë të adresojë sfidat e fragmentarizimit në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme



Institucioni për Tolerancë dhe Mendim Kritik "KRITIKOS"

**Hulumtim i Opinionit Publik**

**Mbi Fragmentarizimin e Shoqërisë në Kosovë**

**Ekipi hulumtues:**

Leart Koshi  
Bleona Zeka  
Ediola Telaku  
Ornela Dakaj  
Erionita Shala  
Arlind Hasani  
Kreshnik Paçarada

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga "Instituti Kritikos"

Prishtinë, Nëntor 2024

## Përmbledhje Ekzekutive

Në Institutin për Tolerancë dhe Mendim Kritik "Kritikos" kemi kryer një studim gjithëpërfshirës mbi fenomenin e fragmentarizimit shoqëror në Kosovë, duke synuar të kuptojmë burimet dhe pasojat e tij në jetën sociale dhe politike të vendit. Studimi ynë përfshiu analiza cilësore dhe sasiore për të identifikuar perceptimet kryesore të qytetarëve mbi faktorët që nxisin ndarjet sociale, ndikimin e mediave sociale dhe rolin e aktorëve të jashtëm në përçarjen e shoqërisë kosovare.

## Metodologjia

Studimi ynë përfshiu më shumë se **340 intervista cilësore**, të realizuara në qendrat urbane të qyteteve kryesore të Kosovës, ku kemi ndërvepruar me individë nga grupe të ndryshme sociale dhe demografike. Këto intervista u kryen në ambiente publike si sheshe, qendra tregtare dhe institucione edukative, për të siguruar një përfaqësim të drejtë të popullatës. Përzgjedhja e mostrës u bë duke përdorur **Formulën e Slovin**, e cila na mundësoi të caktojmë madhësinë optimale të mostrës për të mbledhur të dhëna të vlefshme dhe të përfaqësuara mirë.

Në bazë të kësaj metodologjie, ne siguroam që grupmoshat, nivelet arsimore, përkatësia fetare dhe vendbanimet të përfshihen proporcionalisht. Për të siguruar një analizë të thellë, intervistat u fokusuan në pyetje që prekin përçarjen sociale, ndikimin e mediave dhe perceptimet mbi lajmet e rreme.

Pyetjet ishin lidhur me:


1. **Perceptimet mbi fragmentarizimin shoqëror**
2. **Roli i mediave sociale**
3. **Ndikimi i lajmeve të rreme dhe "fake news"**
4. **Ndikimi i faktorëve të jashtëm**

Për të verifikuar vlefshmërinë e rezultateve tona të mbledhura në terren, ne përdorëm **Teoremën Qendrore të Kufirit**, duke garantuar që shpërndarja e mostrës të jetë përfaqësuese dhe e balancuar. Ky parim na ndihmoi të analizojmë në mënyrë statistikore të dhënat dhe të sigurojmë që ato të reflektojnë perceptimet reale të popullsisë në Kosovë.

## Vlefshmëria e të dhënave

### *Teorema e Qendrore e Kufirit*

Cfarë është teorema e kufirit qendror? Teorema e Kufirit Qendror është një koncept themelor në statistikë që shpjegon se si, kur merren mostra nga çdo popullatë, shpërndarja e mjeteve të mostrës do të përafrojë një shpërndarje normale, edhe nëse vetë popullata nuk shpërndahet normalisht. Ky parim bëhet veçanërisht i dobishëm kur punojmë me popullata të mëdha ose databaza të mëdha të dhënash, sepse na lejon të bëjmë parashikime dhe të nxjerrim përfundime bazuar në mostra relativisht të vogla.




Lakoren në formë të zilës e gjejmë kudo në natyrë në një shpërndarje normale, që shfaqet shpesh në studimet sociale kur analizojmë të dhëna të vazhdueshme sasiore që mund të përfaqësohen me një numër.

Në studimin tonë, ndonëse nuk ishte menduar, ndeshim një herë në këtë lakore.

### **P1: Grupmosha**

Kjo na siguron që shpërndarja e mostrës ishte në pikën e duhur.



Mënyra se si ky pyetësor është strukturuar që në fillim, dhe përgjigjet e mundshme që kemi dhënë, nuk synohej të ishte një studim plotësisht sasior, por një studim cilësor, ku mund të zbulonim dhe të kryqëzonim përgjigjet për të kuptuar më mirë se si e perceptojnë masat trendin.

Këto statistika do të jenë me shume vlerë gjatë gjithë fushatave tona në të ardhmen, duke na ndihmuar të përshtasim strategjitë tona për t'iu drejtuar në mënyrë efektive publikut, për të synuar më saktë fragmentimin dhe për të nxitur një audiencë më të informuar.

Duke marrë në konsideratë këto dy momente të vogla, ne mendojmë se të dhënat e mbledhura janë të besueshme dhe e gjithë puna në terren shkoi pa probleme.

## **Rezultatet**

Ky studim ka për qëllim të analizojë perceptimet e qytetarëve të Kosovës lidhur me fragmentimin social dhe ndikimin e mediave në krijimin e ndarjeve shoqërore. Përmes një pyetësoi të strukturuar, janë mbledhur të dhëna që ndihmojnë në vlerësimin e faktorëve që ndikojnë në qëndrimet e pjesëmarrësve.

Faktorë si mosha, niveli i arsimimit, përkatësia fetare dhe vendbanimi luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e perceptimeve sociale dhe qëndrimeve ndaj mediave. Studimi synon të zbulojë sesi këta faktorë lidhen me përçarjen sociale dhe si ndikimi i mediave përshkallëzon apo zbut këtë fenomen.


Rezultatet e pyetësorit zbulojnë nivele të ndryshme të ndërgjegjësimit mbi problemet sociale dhe rolin e mediave në polarizimin shoqëror. Këto të dhëna mund të ndihmojnë në hartimin e strategjive për të luftuar dezinformimin, për të përmirësuar edukimin mediatik dhe për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve të ndryshme në Kosovë.

## **Demografia e Anketuarve**

Demografia e pjesëmarrësve përbën bazën kryesore për të kuptuar perceptimet e ndryshme mbi fragmentimin social dhe ndikimin e mediave. Pyetësoi përfshin faktorë si mosha, vendbanimi, niveli arsimor dhe përkatësia fetare, të cilët luajnë një rol kyç në formësimin e qëndrimeve shoqërore.


### **Mosha:**


Të anketuarit janë ndarë në grupe moshe, duke përfshirë 18-25, 26-35 dhe mbi 36 vjeç. Të rinjtë janë më të ekspozuar ndaj mediave sociale, një burim kryesor i informacionit dhe shpesh i dezinformative. Përdorimi i shpeshtë i platformave digjitale i bën ata më të ndjeshëm ndaj ndikimeve që thellojnë përçarjen shoqërore.



#### **Vendbanimi:**


Rezidenca urbane ose rurale ndikon në mënyrën se si njerëzit perceptojnë shoqërinë. Banorët e qyteteve kanë më shumë qasje në internet dhe informacione të ndryshme, duke i bërë më të vetëdijshëm për problemet sociale. Në zonat rurale, përçarjet mund të jenë më pak të dukshme për shkak të kontakteve të kufizuara ndërmjet grupeve të ndryshme.





#### **Niveli Arsimor:**


Niveli i arsimit luan një rol të rëndësishëm në perceptimin e problemeve shoqërore. Të anketuarit me arsim universitar tregojnë një kuptim më të thellë të dinamikave sociale dhe mediave. Në të kundërt, ata me arsim më të ulët mund të jenë më të prekshëm ndaj lajmeve të rreme dhe teorive të konspiracionit.



#### **Përkatësia Fetare:**

Shumica e pjesëmarrësve identifikohen si myslimanë, megjithëse disa preferuan të mos përgjigjen. Përkatësia fetare mund të ndikojë në perceptimin e përçarjeve


ndërfetare dhe marrëdhënieve shoqërore, veçanërisht në një shoqëri me një histori të ndërlikuar politike dhe fetare si Kosova.




### **Perceptimi mbi Fragmentarizimin Social**

Perceptimi i qytetarëve të Kosovës mbi fragmentimin social pasqyron një ndërgjegjësim të thellë mbi tensionet ekzistuese në shoqëri dhe ndikimin që mediat sociale kanë në përkeqësimin e situatës. Përmes një sërë pyetjesh të strukturuar, pjesëmarrësit ndanë qëndrimet e tyre mbi përçarjen shoqërore, ndarjen fetare dhe përhapjen e dezinformatave. Përgjigjet sugjerojnë se perceptimet e fragmentimit janë të lidhura ngushtë me faktorët socialë, ekonomikë dhe kulturorë.


Shumica e të anketuarve e konsiderojnë përçarjen sociale si "Mjaft të pranishme" ose "Shumë të pranishme", duke treguar një vetëdije të lartë mbi tensionet dhe ndarjet në shoqëri. Kjo tregon një përjetim të drejtpërdrejtë të problemeve që lidhen me diskriminimin, ndarjet politike dhe mungesën e unitetit kombëtar. Rezidenca urbane dhe niveli më i lartë i arsimimit duket se ndikojnë në perceptimin më të theksuar të përçarjes, pasi këta individë janë më të ekspozuar ndaj lajmeve dhe zhvillimeve socio-politike.



Ndikimi i mediave sociale është identifikuar si një faktor kyç që përkeqëson përçarjet. Shumica e të anketuarve mendojnë se platformat digjitale kanë një ndikim shumë të madh në fragmentimin shoqëror, duke përhapur lajme të rreme dhe promovuar qëndrime polarizuese. Kjo sugjeron se përdoruesit aktivë të mediave sociale, sidomos të rinjtë, janë më të ndjeshëm ndaj këtij ndikimi, për shkak të ndërveprimit të përditshëm me përmbajtje që shpesh është e njëanshme apo manipuluese. Përhapja e dezinformative, e njohur si "fake news", konsiderohet si një nga sfidat më të mëdha, duke ndikuar drejtpërdrejt në qëndrimet e pjesëmarrësve ndaj ngjarjeve të ndryshme sociale dhe politike.









Në lidhje me përçarjet fetare, përgjigjet janë të ndryshme. Disa të anketuar e shohin këtë fenomen si një çështje problematike, ndërsa të tjerë nuk e konsiderojnë atë si një faktor të rëndësishëm në përçarjen e shoqërisë. Kjo mund të lidhet me përkatësinë fetare të pjesëmarrësve, ku ata që i përkasin grupeve minoritare mund të ndjejnë më shumë ndarje dhe diskriminim. Në përgjithësi, të dhënat sugjerojnë një vetëdije të lartë mbi sfidat që paraqet fragmentimi shoqëror dhe nevojën për masa që promovojnë unitetin, tolerancën dhe informimin e saktë të publikut përmes burimeve të besueshme të informacionit.




## Mediat dhe Ekstremizmi

Në shoqërinë kosovare ekziston një perceptim i përhapur se mediat luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e ekstremizmit dhe sjelljeve të dhunshme, veçanërisht tek të rinjtë. Të dhënat nga pyetësi tregojnë se shumica e të anketuarve besojnë se platformat mediatike shpesh normalizojnë sjelljet negative përmes përmbajtjeve të njëanshme, të dhunshme apo të ngarkuara me mesazhe propagandistike. Kjo dukuri shihet si një kërcënim i vazhdueshëm që ndikon drejtpërdrejt në perceptimet dhe sjelljet e individëve, duke kontribuar në polarizimin e mëtejshëm të shoqërisë.

Pjesëmarrësit më të rinj, që janë përdorues të rregullt të mediave sociale, lojërave online dhe platformave të transmetimit, raportojnë një ndikim më të madh të përmbajtjeve të papërshtatshme. Ata përballen me mesazhe të dhunshme që shpesh normalizohen përmes argëtimit ose propagandës së fshehur. Në këtë kontekst, roli i edukimit mediatik dhe kontrollit të përmbajtjeve bëhet thelbësor për të zvogëluar ndikimet negative dhe për të promovuar një përdorim më të vetëdijshëm të teknologjisë digjitale.






Lidhur me ndikimin e agjendave të huaja, Serbia dhe Rusia përmenden më shpesh si aktorë që mund të financojnë përçarjen shoqërore në Kosovë. Këto përgjigje pasqyrojnë një shqetësim historik dhe gjeopolitik që mbetet i gjallë në ndërgjegjen publike. Konfliktet e mëparshme dhe tensionet aktuale politike vazhdojnë të formësojnë perceptimet e qytetarëve, duke krijuar një ndjenjë të fortë të kërcënimit të jashtëm. Këto faktorë theksojnë rëndësinë e sigurimit të një mjedisi informues të besueshëm dhe të pavarur, që mund të ndihmojë në zvogëlimin e ndikimeve të jashtme destabilizuese.

### Zgjidhjet e Propozuara për Zvogëlimin e Përçarjes

Pjesëmarrësit e pyetësorit theksojnë nevojën për masa të qëndrueshme që synojnë zvogëlimin e përçarjes sociale në Kosovë. Edukimi social dhe ndërgjegjësimi mbi rreziqet e dezinformimit konsiderohen si strategjitë më të efektshme për përmirësimin e situatës. Të anketuarit sugjerojnë programe që përfshijnë informimin publik mbi përdorimin e mediave sociale, përhapjen e lajmeve të rreme dhe ndikimin e tyre negativ në marrëdhëniet ndërshoqërore.



Një tjetër propozim i rëndësishëm është nxitja e nismave që promovojnë integrimin shoqëror përmes aktiviteteve të përbashkëta kulturore, sportive dhe arsimore. Këto aktivitete mund të ndihmojnë në krijimin e një klime më të hapur dhe të qëndrueshme, ku individë nga komunitete të ndryshme mund të bashkëpunojnë dhe të zhvillojnë një mirëkuptim të ndërsjellë.

Është vënë re se ata që janë më të vetëdijshëm për ndikimin e përçarjes sociale kanë më shumë gjasa të propozojnë masa konkrete për përmirësimin e situatës. Kjo tregon rëndësinë e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe në zhvillimin e strategjive për ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Për këtë arsye, qeveria dhe organizatat joqeveritare mund të luajnë një rol kyç në zbatimin e këtyre masave.

## Përfundime Kryesore dhe Rekomandime

Studimi nxjerr në pah rolin qendror të mediave sociale dhe portaleve online në përhapjen e përçarjes sociale përmes lajmeve të rreme dhe përmbajtjeve polarizuese. Pjesëmarrësit shprehin shqetësime për ndikimet e huaja, duke theksuar nevojën për transparencë dhe rregullim të mediave. Edukimi social dhe zhvillimi i mendimit kritik konsiderohen zgjidhje kyçe për zvogëlimin e përçarjes. Politikat që mbështesin mbikëqyrjen mediatike dhe luftën kundër dezinformimit janë të domosdoshme për të përmirësuar klimën shoqërore dhe për të promovuar një shoqëri më të qëndrueshme dhe të informuar.

## Rekomandime Politike

Për të adresuar problemet e fragmentimit social dhe ndikimin negativ të mediave, propozohet një fushatë kombëtare për edukim mediatik, e cila do të përqendrohet në informimin e qytetarëve për rreziqet e keqinformimit dhe dezinformimit në platformat online. Gjithashtu, duhet të promovohen nisma të ndërgjegjësimit social që nxisin integrimin dhe tolerancën ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore, për

të krijuar një mjedis më të bashkuar. Përveç kësaj, është e nevojshme të miratohet një legjislacion i rreptë për mediat, që do të rrisë përgjegjësinë e mediave dhe do të mbrojë shoqërinë nga përmbajtjet që kontribuojnë në ndarjet sociale.